

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 30, 20 KORRIK – 26 KORRIK 2015

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUJË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZH, LUSHNJË, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEÇ, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 30

	JAVA 30
DIARRE PA GJAK	3.058
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	4.608
INF. RESP. TE POSHTËME	1.959
RASH ME TEMPERATURË	1
VERDHEZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	2
Numri i Njësive Raportuese	399
% e Njësive Raportuese	93% (399/427)

Rash me temperaturë


Rasti është raportuar nga rrethi i Matit. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit, rasti nuk është suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Duke u nisur nga shpërthimet epidemike që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Pediatër dhe Infeksionistë dhe marrja e mostrave të gjakut nga rastet e suspektuara.


Ethe të Pashpjegueshme

Rastet janë të grupmoshës 15-44 vjeç dhe janë raportuar nga rrethi i Pogradecit. Më pas diagnoza rezultoi “Suspekt Brucelozë”

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet i qëndrueshëm në javën e 30 krahasuar me javën paraardhëse, java 29.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarreve pa gjak” paraqet 6% ritje në javën e 30 krahasuar me javën paraardhëse, java 29.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 – 30 të vitit 2014 dhe të vitit 2015. Numri i rasteve.




Në javën e 30 të vitit 2015 vërehet trend i qëndrueshëm i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 13% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 29 dhe javën 30 të vitit 2015. Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën 30 të vitit 2015. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 01 – 30 të vitit 2014 dhe të vitit 2015. Numri i rasteve.




Në javën e 30 të vitit 2015 vërehet një trend në ritje i numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 9% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 29 dhe javën 30 të vitit 2015. Incidenca (raste/10.000)




Shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas grupmoshës në javën 30 të vitit 2015. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)



Incidenca më e lartë se diarreve vërehet në grupmoshën pediatrike 0-14 vjeç.

Incidenca e Diarreve sipas rretheve (raste/10.000 banorë) në javën e 30



Vërehet rritje e numrit të rasteve me diarre por shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Kontaktet me epidemiologët e rretheve janë të vazhdueshme për njoftimin në kohë në IShP të çdo ngjarjeje shëndetësore të pazakonshme, ne veçanti në zonat turistike.

Eshte përforcuar survejanca laboratorike për marrjen e mostrave për çdo rast të dyshuar që mund të jetë shkak për një shpërthim me natyrë hidrike apo ushqimore dhe kryejën e hetimit epidemiologjik për marrjen e masave të kontrollit dhe të parandalimit.

Deri tani nuk kanë ndodhur shpërthime me origjinë ushqimore apo hidrike.

Nivelet e Raportimit për javën e 30 sipas rretheve, në përqindje.

